



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 24/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) - KQZ, për tërheqjen e ankesës së parashtruar ndaj GI Za Kosovsko Pomoravlje me seli në Ranillug, në seancën e panelit të mbajtur me 12.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohet e tërhequr ankesa që ka të bëjë me Iniciativën Qyetare GI Za Kosovsko Pomoravlje të parashtruar në PZAP nga Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) - KQZ.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar nga ZRPPC-ja një kërkesë për tërheqjen e ankesës të parashtruar në PZAP kundër Iniciativës Qyetare GI Za Kosovsko Pomoravlje, në të cilën kërkohet që të tërhiqet nga shqyrtimi ankesa e lartpërmendur pasi që iniciativa në fjalë e ka dorëzuar raportin e shpenzimit të fushatës zgjedhore, por se gabimisht është ndërruar me një subjekt tjetër që nuk e ka sjellur këtë raport.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës së sipërhënuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohe pjesa që ka të bëjë me iniciativën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa

A nr. 24/2014 më datën 12.03.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

